



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 24/10/2012  
Nr.0204-1123

**PËR:** Ali Berisha, Kryetar i Komunës së Pejës  
Arbëresha Ajdini Nallbani, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Pejës

**LËNDA:** Konfirmim i Ligjshmërisë së Vendimeve të së Komunës së Pejës,  
Nr.01-400/6799, Nr.320/7091  
Pranuar me datën 16.10.2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, Pas shqyrtimit të Vendimeve të miratuar me datë 29/06/2012 nga Kuvendi i Komunës së Pejës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtyre akteve dhe vlerëson se janë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Aktet juridike të listuara si vijon, prodhojnë efekt të plotë juridik.

- Vendimi për lirimin nga pagesa e takses së Komunës për bizneset e regjistruara nga Janari i vitin 2013, dhe bizneset që kanë veprimtari prodhuese më të punësuar me mbi 5 ( pesë) punëtorë për 3 (tri) vite".
- Vendim për themelimin e dy vendëgjyetjeve në territorin e Komunës së Pejës.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
**Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,**

**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së  
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave  
Arkivit të MAPL-së



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Dana, 24/10/2012  
Br.0204-1123

**Za:** Ali Berisha, Gradonačelnik Opštine Peć  
Arbëresha Ajdini Nallbani, Predsedavajuća Skupštine Opštine Peć

**Predmet:** Potvrda zakonitosti Odluka Skupštine Opštine Peć ,  
Br.01-400/6799, Br.320/7091  
Primljeno dana 16.10.2012

Poštovani-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, na osnovu svog mandata određenog po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatka XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja usvojenih odluka dana 29/06/2012 od Skupštine Opštine Peć, **POTVRDJUJE** zakonitost ovih akata i procenjuje da su u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu.

Navedena pravna akta, koja proizvode puni pravni efekat.

- Odluka o oslobadjanju od plaćanja takse opštini za biznese registrovanih od Januara 2013 god. i biznisa koji imaju poslovnu delatnost za zapošljenih preko 5 (pet) radnika za 3 (tri) godine".
- Odluka o osnivanju dva mesta za lov na teritoriji Opštine Peć.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,  
Zamenik Premijera i Ministar MALS,

**Kopje:** Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së  
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave  
Arkivit të MAPL-së





Në bazë të nenit 11. Nenet 12.paragrafi 1. të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04.qershor 2008), nenit 2. të Ligjit Nr.03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal ("Gazete zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.27.datë: 03.Qershor 2008"), dhe nenit 8.paragrafi 1.të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë: 29.shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28.Tetor 2012, pas shqyrtimit të Propozimit për lirim nga Taksa komunale për bizneset e reja të regjistruara në Komunën e Pejës, nga janari 20013, në Rekomandim të Komitetit për Politikë e Financa, njëzërit muar këtë

### V E N D I M

I.MIRATOHET Propozimi për lirim nga pagesa e takses komunale dhe atë:

1.i të gjitha bizneseve të reja, të regjistruara nga janari 2013, për 2 (dy) vite, dhe  
2.të gjitha bizneseve të reja që kanë veprimtari prodhuese me të punësuar mbi 5 (pes) punëtor të regjistruara nga janari 2013, për 3 (tre) vite.


II.Për zbatimin e këtijë Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në koordinim me Drejtorinë për Buxhet e Financa të Komunës së Pejës.

III.Implementimi i këtijë Vendimi do të bëhet nga janari i vitit 2013.

IV. Vindimit ti dërgohet: Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Drejtorisë për Buxhet e Financa, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe një kopje i bashkangjitet Procesvërbalit nga takimi i Kuvendit Komunal i mbajtur me datë: 28.Tetor 2012.

I.Numër: 400 – 6799/2012  
Pejë, date: 28.shtator 2012.

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E PEJËS  
KUVENDI KOMUNAL PEJË



KRYESUESJA,  
Dr.Arbëresha Ajdini Nallbani





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
RAPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS    MUNICIPALITY OF PEJA    OPŠTINA PEĆ

Në bazë të nenit 11. dhe nenit 12 paragrafi 1. të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04.qershor 2008"), nenit 8 paragrafi 8.1.,8.4 dhe 8.5. të Udhëzimit Administrativ të MA-NR.10/2007 Kriteret e caktimit të Zonave dhe procedurat për themelimin e vendëgjuetive dt.14/09/2007, dhe nenit 8 të Statutit të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë: 29.shtator 2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28.shtator 2012, pas shqyrtimit të Propozimit për themelimin e 2 (dy) vendgjuetive të përbashkëta në Komunën e Pejës, bazuar në Pelqimin Ref.ZM-01-362/12 date: 09.072012 të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomisë të Republikës së Kosovës, konform dispozitive ligjore në fuqi, dhe në rekomandim të Komitetit për Politikë e Financa, njëzërit muar këtë

V E N D I M

I. MIRATOHET Propozimi për themelimin e vendgjuetive dhe THEMELOHEN 2 (dy) Vendgjueti të përbashkëta në territorin e Komunës së Pejës, me sipërfaqe të përgjithshme prej 60.271,428 ha, sipas hartes së bashkangjitur, dhe atë:

1. Vendgjuetia Nr.1. emërtuar: "Rafshi i Dukagjinit", me sipërfaqe prej: 31.845,268 ha, për aktivitete të gjuetie në 22.291,687 ha, dhe
2. Vendgjuetia Nr.2. emërtuar: "Rugova", me sipërfaqe prej: 30.426,160 ha, për aktivitete gjuetie në 21.298,312 ha.

II.Vendgjuetit e përbashkëta nga pika 1 e këtij vendimi duhet të jenë të qëndrueshme të shfrytëzuara sipas tërësisë së ekosistemit, baraspeshës ekologjike, kultivimit, mbrojtjes dhe shtimit të kafshëve të egra si pasuri natyrore kombëtare me interes të përgjithshëm që gëzon mbrojtje të vacantë në harmoni me dispozitat: nenin 19 paragrafi 19.2 dhe nenin 34 të Ligjit Nr.02/L – 53 për Gjuetitë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.08. dt.01.01.2007) dhe nenit 8 paragrafi 8.1.,8.4 dhe 8.5. të Udhëzimit Administrativ MA-NR.10/2007. Kriteret e caktimit të Zonave dhe procedurat për themelimin e vendëgjuetive dt.14/09/2007.

III.Për zbatimin e këtijë Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Hidroekonomi e KK.Pejë.

IV. Vendimi Ti dërgohet: Kryetarit të Komunës, DBPH.-ca , të KK.Pejë, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Prishtinë dhe një kopje i bashkangjitet Procesverbali nga takimi i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me datë: 28.shtator 2012.

I.Numër: 320 – 7091/2012  
Pejë, date: 28.Shtator 2012.

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E PEJËS  
KUVENDI KOMUNAL PEJË



KRYESUESJA,  
Dr.Arbëresha Ajdini Nallbani